

VENDIM
Nr. 401, datë 20.6.2012

PËR KRIJIMIN E AKADEMISË SË ARTEVE, SHKODËR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6, 9, 41, 76 e 77 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Krijimi dhe misioni i Akademisë së Arteve, Shkodër

1. Krijimin e Akademisë së Arteve, Shkodër, si institucion publik i arsimit të lartë, e cila do të ushtrojë veprimtarinë në qytetin e Shkodrës.

2. Misioni i Akademisë së Arteve, Shkodër, përfshin:

- a) ofrimin e studimeve universitare në fushën e artit dhe kulturës;
- b) zhvillimin dhe mbrojtjen e dijeve nëpërmjet mësimdhënies dhe veprimtarisë artistike që kryhet brenda dhe jashtë vendit;
- c) formimin e studiuesve të rinj në fushat teorike të vlerësimit të artit e kulturës;
- ç) thellimin e kualifikimit profesional e shkencor të specialistit të lartë në fushën e artit dhe kulturës;
- d) kryerjen e kërkimeve shkencore për të zhvilluar e tejçuar artin e kulturën;
- dh) ndihmesën në rritjen e standardeve të demokracisë e të qytetërimit dhe cilësisë së shoqërisë, si dhe përgatitjen e të rinjve për një shoqëri të tillë.

II. Struktura akademike e Akademisë së Arteve, Shkodër

Struktura akademike e Akademisë së Arteve, Shkodër, përfshin njësitë kryesore, si më poshtë:

- a) Fakulteti i Muzikës, me këtë përbërje si njësi bazë:
 - i) Departamenti i Disiplinave Instrumentale;
 - ii) Departamenti i Kompozicion-Dirigjimit;
 - iii) Departamenti i Artit Vokal.
- b) Fakulteti i Artit Figurativ, me këtë përbërje në njësi bazë:
 - i) Departamenti i Artit Figurativ;
 - ii) Departamenti i Pikturës;
 - iii) Departamenti i Artit Grafik.

III. Programet e studimeve të Akademisë së Arteve, Shkodër

Akademia e Arteve, Shkodër, ofron programet e mëposhtme të studimit, si dhe çdo program tjetër të miratuar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore:

- a) Fakulteti i Muzikës ofron:
 - i) programet e studimit të ciklit të parë në “Violinë”;
 - ii) programet e studimit të ciklit të parë në “Piano”;
 - iii) programet e studimit të ciklit të parë në “Kanto”;
 - iv) programet e studimit të ciklit të parë në “Kompozicion”;
 - v) programet e studimit të ciklit të parë në “Dirigjim”.
- b) Fakulteti i Artit Figurativ ofron programet e studimit të ciklit të parë në “Pikturë”.
- c) Programi i studimit të ciklit të parë në “Pikturë-Grafikë”, që ofrohet aktualisht nga universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, transferohet në Fakultetin e Artit Figurativ të Akademisë së Arteve, Shkodër.

IV. Dispozita kalimtare dhe të fundit

1. Studentët, të cilët kanë filluar programin e studimit të ciklit të parë në “Pikturë-Grafikë”, në universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, në përfundim të studimeve do të pajisen me diplomë universitare përkatëse, të lëshuar nga universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër.

2. Akademia e Arteve, Shkodër, duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Financave dhe Akademia e Arteve, Shkodër, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha